

KRONIKË

## Sërish gjenden armë në veri



Policia ka njoftuar se sërish janë gjetur armë, pajisje për prodhim të kriptovalutave dhe pajisje të tjera të dyshimta në veri të Mitrovicës.

Siç është bërë e ditur, këto armë dhe pajisje tjera të dyshuara janë gjetur të mërkurën në një shtëpi dhe objekte përcjellëse të saj në rrugën “Kollashini” në Mitrovicën e Veriut.

“Dëshmitë e gjetura dhe të konfiskuara janë: Një armë e gjatë (pushkë ajrore), pesë kartela grafike për prodhimin e kriptovalutave me pajisje përcjellëse, 42 minera për prodhim të kriptovalutave me pajisje përcjellëse, një shtëpizë e kompjuterit, një karikator i revoles, 14 fishekë të revoles kalibri 9 mm, një radiolidhje, një kamerë vëzhgimi, një divijar, një vulë metalike dhe një letërnjoftim”, thuhet në njoftim. Më tej bëhet e ditur se aparatet për prodhimin e kriptovalutave do t’i dorëzohen Doganës së Kosovës. Tutje thuhet se lidhur me rastin nuk është arrestuar asnjë person.

“Në vendin e ngjarjes nuk është hasur ndonjë person i dyshuar, mirëpo është identifikuar një person dhe i cili është me interes për Policinë që të intervistohet. Në lidhje me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit i cili ka urdhëruar iniciimin e rastit ‘Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i pa autorizuar të armëve’”, thuhet tutje në njoftim.

22 janar 2025 16:45

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t’i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#MITROVICA E VERIUT

#ARME

#POLICIA E KOSOVËS

#MJETE TE DYSHUARA

#VERIU